



KONKURS PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË EKSPOZITËN E 61 NDËRKOMBËTARE FIGURATIVE NË VENECIA NË VITIN 2026 NË ORGANIZIM TË “BIENALES SË VENECIAS” (LA BIENNALE DI VENEZIA)

Në bazë të nenit 64 të Ligjit të Kulturës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16 dhe 11/18),

Ministria e Kulturës dhe e Turizmit shpall

**KONKURS
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT ME INTERES NACIONAL NË KULTURË NGA FUSHA
E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT NË EKSPOZITËN E 61 NDËRKOMBËTARE FIGURATIVE
NË VENECIA NË VITIN 2026 NË ORGANIZIM TË “BIENALES SË VENECIAS” (LA
BIENNALE DI VENEZIA)**

I. INFORMACIONET E PËRGJITHSHME

Ministria e Kulturës dhe e Turizmit shpall konkurs për financim të projektit me interes nacional në kulturë nga fusha e bashkëpunimit ndërkombëtar për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut në ekspozitën e 61 ndërkombëtare figurative në Venecia, e cila do të mbahet nga 9 maj deri më 22 nëntor 2026, me organizim të Bienales e Venecias (La Biennale di Venezia) <https://www.labiennale.org/en/architecture/2025>.

Ministria e Kulturës dhe e Turizmit do të sigurojë mjete nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 për pjesëmarrje në financimin e projektit në njërin nga kategoritë e mëposhtme:

- 1. Ekspozitë/projekt të një autori**
- 2. Ekspozitë/projekt të një grupi të autorëve.**

II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE NË KONKURS

- Të drejtën e pjesëmarrjes në konkurs kanë vetëm personat juridikë me projekte/ekspozita nga kategoritë e përcaktuara në këtë konkurs. Personi juridik duhet domosdoshmërisht të ketë lidhur marrëveshje për rregullimin e të drejtës së autorit me autorin(ët) e ekspozitës/projektit.
- Me persona juridikë nënkuptohen institucionet nga fusha e kulturës (nacionale, lokale apo private), shoqatat, asociacionet dhe personat e tjerë juridikë të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për kryerjen e veprimtarive nga sfera e kulturës në pajtim me ligjin.
- Pjesëmarrësi i konkursit (nëse ka qenë përfitues i mjeteve nga buxheti i Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit) duhet të ketë përmbushur detyrimet e tij ndaj Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit në 3 vitet e fundit.
- Në konkurs përcaktohen prioritetet dhe kushtet që duhet t'i përmbushë aplikanti.
- Dokumentacioni i obligueshëm i kërkuar që vërteton përmbushjen e prioritetëve dhe kushteve përcaktohet në Fletëparaqitje, që është pjesë përbërëse e Konkursit.

III. MËNYRA E APLIKIMIT DHE AFATI I DORËZIMIT TË FLETËPARAQITJEVE

- Paraqitja e projektit bëhet me dorëzimin e fletëparaqitjes së kompletuar për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut në ekspozitën e 61 ndërkombëtare figurative në Venecia në vitin 2026, organizuar nga "Bienalja e Venecias" (La Biennale di Venezia).



- Fletëparaqitja duhet të shkarkohet nga ueb-faqja e Ministrisë së Kulturës dhe e Turizmit (www.kultura.gov.mk) dhe të plotësohet në mënyrë elektronike duke vendosur të dhënat në vendin e shënuar.
- Fletëparaqitjet mund të dorëzohen në Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit me postë (rr. "Gjuro Gjakoviq" nr. 61, 1000 Shkup), me datën e vulës postare ose personalisht në arkivin e Ministrisë jo më vonë se ora 15:30 gjatë ditëve të punës.
- Këto fletëparaqitje nuk do të merren parasysh: të dorëzuara pas afatit të konkursit, të plotësuara në formular të papërshtatshëm, fletëparaqitje të paplotësuara dhe jo të plota- pa dokumente të bashkangjitura që kërkohen domosdoshmërisht. Materialet e dorëzuara me fletëparaqitjet e Konkursit nuk kthehen.
- **Konkursi do të zgjasë nga 31.5.2025 deri 30.6.2025.**

IV. INFORMIM PËR REZULTATET E KONKURSIT

- Rezultatet e konkursit do të shpallen në ueb-faqen e Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit.
- Të gjithë pjesëmarrësit do të informohen me shkrim për rezultatet e konkursit me vendim të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit.

V. PËRQINDJA E PJESËMARRJES SË MINISTRISË SË KULTURËS DHE TURIZMIT NË FINANCIMIN E PROJEKTIT

Përqindja e pjesëmarrjes së Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit në financim të projektit me interes nacional në kulturë nga fusha e bashkëpunimit ndërkombëtar për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut në ekspozitën e 61 ndërkombëtare figurative në Venecia, e cila do të mbahet nga 9 maj deri më 22 nëntor 2026 e organizuar nga "Bienalja e Venecias" (La Biennale di Venezia), është në pajtim me mjetet e parapara për këtë qëllim në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 sipas fushave dhe aktiviteteve të veçanta.

VI. INFORMACIONE SHITESË

Informacione shitesë në lidhje me konkursin mund të merren nga Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe bashkëpunim me UNESCO-n në numrin e telefonit: 02/3240 549 ose në adresën e mëposhtme elektronike: lj.stefanovska@kultura.gov.mk.